

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Master i Shkencave në

"E drejtë civile dhe tregtare"

Kolegji Universitar "I Biznesit"

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Sherif BUNDO

Prof. As. Dr. Luan VELIQOTI

Tetor 2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit

Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "I Biznesit"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Drejtësisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 651, datë 14.09.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASH Nr. 545, datë 13.11.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare"
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ESC
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve	
	2016-2017	28
	2017-2018	18

HJRJE

Të dhëna për programin e studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale"

Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" i Kolegjit Universitar "I Biznesit" ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë, përkatësisht nga Departamenti i së Drejtës Civile.

Kolegji Universitar "I Biznesit" (KUB), ka filluar veprimtarinë e tij në sistemin e arsimit të lartë si "Akademika Profesionale e Biznesit" me VKM Nr. 651, dt. 14.09.2011. Institucioni është akredituar me Urdhër Nr. 557, datë 16.11.2012 dhe riakredituar me VBA Nr. 100, datë 10.11.2017, me kohëzgjatje 4 vite akademike. Me Urdhër të MASR Nr. 39, datë 30.01.2018 është miratuar Statuti i Institucionit si Kolegji Universitar "I Biznesit".


Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" është hapur me VKM Nr. 651, datë 14.09.2011 dhe është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 545, datë 13.11.2012, në bazë të Vendimit Nr.203, datë 29.07.2011. Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.6, datë 06.01.2016, është bërë regjistrimi i formës së diplomës. Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" është organizuar në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe 120 ECTS, ku çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë vendosën: Prof. Dr. Sherif BUNDO dhe Prof. As. Dr. Luan VELIQOTI, ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Znj. Ersi Dako.

Më datë 19.10.2018, Institucioni është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 22.10.2018, përmes AMS dhe shkresës zyrtare Nr. 473 Prot., datë 22.10.2018, Institucioni përcjell komentet në lidhje me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. GVJ dakordëson se KUB-i nuk ka shprehur kundërshti por më shumë komente rreth opinionit të shprehur nga GVJ. Komentet nuk janë thelbësore dhe KUB-i shpreh më shumë faktin që gjërat nga viti në vit janë përmirësuar. Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË


I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

- a) Institucioni të bëjë përpjekje për të gjeneruar sa më shpejtë një bilanc financiar pozitiv.
- b) Të merren masa për të rritur numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi, një pjesë thelbësore për mbarëvajtjen e institucionit.
- c) Të bëhet përpjekje që studentët të kenë sa më shumë akses në bibliotekat on-line.
- d) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

Nga verifikimi në institucion dhe nga raporti i vetëvlerësimit del qartë se të gjitha rekomandimet e Këshillit të Akreditimit janë plotësuar. Institucioni ka tashëm një bilanc financiar pozitiv. Është rritur numri gjithsej i studentëve në Kolegj dhe është rritur gjithashtu numri i studentëve të regjistruar në programin Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", nga 13 studentë në vitin e parë akademik 2012-2013 në 23, 49, 28 dhe 18 në vitin e fundit akademik. Studentët kanë akses në bibliotekën online dhe studentët japin edhe provimin e gjuhës angleze në përfundim të studimeve.

Në përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se rekomandimet e dhëna në Vendimin e Këshillit të Akreditimit në kuadër të akreditimit të parë janë përmbushur.



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", ofruar nga KUB, ka si synim të formojë specialistë me formim profesional dhe teorik në fushën e të drejtës tregtare dhe të së drejtës civile në RSH. Ky program shkon në harmoni me profilin e Kolegjit, që është i fokusuar në fushën e biznesit, të njohjes, të menaxhimit dhe të mbrojtjes së të drejtave tregtare dhe civile.

Ky program është ndërtuar në përputhje dhe në vazhdim me programet e studimit bachelor të të njëjtit institucion të arsimit të lartë dhe vijon si rrjedhje normale e studimeve në një nivel më të lartë dhe më të profilizuar. Programi, i pret studentët nga niveli Bachelor në "E Drejtë Biznesi" dhe Bachelor në "Drejtësi".

KUB ka formatuar program me objektiva të qarta të karakterit strategjik dhe të karakterit pedagogjik. Përmendim disa nga objektivat kryesorë strategjike si:

- të pajisë studentët me njohuri të avancuara në fushën e të drejtës civile dhe të të drejtës së biznesit;
- të krijojë diploma me nivel të lartë profesional dhe juridik që të jenë të aftë për të marrë vendime me efekte juridike, tregëtare, dhe ekonomiko/shoqërore;
- të pajisë studentët me paketën e duhur të njohurive të karakterit teknik dhe legjislativ të të drejtës civile dhe tregëtare në vendin tonë si dhe të asaj ndërkombëtare, në një kohë që marrëdhëniet tregtare të bizneseve janë bërë gjithnjë dhe më intensive të bizneseve shqiptare dhe atyre rajonale dhe europiane.

Në dokumentat e KUB-it ka të nënvizuar edhe objektiva të karakterit shkencor dhe pedagogjik që kompletojnë programin e studimit, në përputhje me kërkesat e ligjit për Arsimin e Lartë dhe të akteve të tjera rregullatore të MASR.

Disa të dhëna të tjera të përgjithshme janë:

Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" është me 120 kredite. Ndërtohet në forma të miksuara të mësimdhënies që përfshijnë leksionet, seminarët, diskutimin shkencor, punimet e pavarura, praktikat profesionale, punimin e mikrotezës dhe mbrojtjen e diplomës. Në fund të studimit, studentet që kanë përmbushur detyrimet e programit pajisen me diplomën përkatëse.

Programi i studimit zgjat dy vite akademike, me kohë të plotë, dhe me një numër të lëndëve të ndërtuar në përputhje me kërkesat e sistemit të Bolonjës. Të dhënat në vijim prezantojnë strukturën e disiplinave të programit:

- | | |
|---|------------------|
| 1. disiplina të formimit bazë | (12 ECTS) = 10% |
| 2. disiplina të formimit karakterizues | (49 ECTS) = 40 % |
| 3. disiplina të ngjashme ose integruese | (12 ECTS) = 10 % |
| 4. disiplina formuese me zgjedhje | (7 ECTS) = 7 % |

5. gjuhe e huaj, informatike, praktike
6. Punimi i diplomes

(10 ECTS) = 10 %
(30 ECTS) = 23 %

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për rruajtjen e vlerave kulturore të kombit;</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave, në "E drejtë civile dhe tregtare" është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit KUB.</p> <p>Në qëllimin e cilësuar të KUB-it, nënvizohet se ky institucion, nëpërmjet këtij programi, ka për qëllim të përgatisë specialistë, ekspertë dhe studiues të fushës së të drejtës civile dhe tregtare, fushë në të cilën ndihet mungesa e këtyre profesioneve në tregun shqiptar.</p> <p>KUB-i nuk posedon një studim tëpërditësuar të tregut të punës për këtë diplomë dhe program studimi, por nisur nga kontaktet e shumta dhe raportet intensive që ka me botën e biznesit dhe institucionet e biznesit ka krijuar bindjen se programi kërkohet nga tregu dhe të diplomuarit janë në formatin që i nevojiten tregut të punës.</p> <p>Programi i studimit merr parasysh që struktura e tij dhe njohuritë që marrin studentët të jenë në përputhje me fazën e zhvillimit ekonomik, social dhe legjislativ të vendit si dhe procesin e integritimit të vendit në strukturat euroatlantike.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit është përshtatur me strategjinë dhe veçoritë institucionale të KUB-it, si institucion i profilizuar për studime të fushës së të drejtës dhe të menaxhimit të biznesit.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në RSH	
<p>Kriteri 1 Përbajtja e programeve të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimeve është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga korniza shqiptare</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me aktet ligjore të fushës së arsimit në RSH, me ligjin për arsimin e lartë si dhe me aktet e tjera të legjislativitetit si dhe në harmoni me sistemin arsimor të Bolonjës.</p> <p>Emërtimi i programit të studimeve Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", është në përputhje me nivelin e kualifikimit të studentëve, me</p>

¹ GVJ duhet të shprehë me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

e kualifikimit;	stadin e studimeve të ciklit të dytë, me numrin dhe strukturën e syllabusave, dhe me kornizën shqiptare të kualifikimit në këtë fushë.
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit;</p>	<p>KUB ka hartuar dhe ka miratuar në nivel institucional Planin strategjik të Zhvillimit për periudhën 2015-2020, plan në të cilin parashikohet zhvillimi dhe përmirësimi i programeve të studimit, sikurse edhe përmirësimi i procesit dhe i rezultateve të mësimdhënies, të procesit të mësimnxënies dhe të vetëzhvillimit të institucionit.</p> <p>Në këtë plan zhvillimi ka rubrika të veçanta për perspektivat e programeve të studimit si dhe për ambiciet e institucionit për secilin program dhe diplomë.</p>
<p><u>Konkluzione:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • KUB e bazon veprimtarinë e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në RSH, si në nivel institucional, ashtu edhe për secilin program studimi në veçanti. • Programi i studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" është hartuar në përputhje me misionin dhe planin e zhvillimit strategjik të institucionit, në përputhje me kartën e Bolonjës, si dhe me profesionalizmin dhe eksperiencën e fituar prej institucionit në këto vite. <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.</p>	



2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit.


Përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" është Fakulteti i Drejtësisë që është një nga njësitë kryesore të institucionit. Fakulteti përbëhet nga tre departamente dhe secili departament është i kompletuar me personelin e nevojshëm akademik dhe pedagogjik të përshtatshëm për të përmbushur nevojat e programit të studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare". ~~Personeli është i kontraktuar si personel efektiv dhe si personel i kontraktuar.~~ Tre departamentet e Fakultetit të Drejtësisë janë: Departamenti i së Drejtës Civile, Departamenti i së Drejtës Publike dhe Departamenti i së Drejtës Penale. Struktura dhe kualifikimi i secilit Departament me stafin akademik paraqitet në tabelën 1 të Aneksve.

Duhet nënvizuar se Departamentet, edhe pse me staf akademik të plotësuar, ka nivel relativisht të kufizuar në nivelin akademik të stafit. Numri i pedagogëve me tituj dhe grada shkencore, të përshtatshëm për të dhënë mësim dhe për të mbuluar mësimdhënien në diplomën Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", është i limituar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit dhe Departamentit



Fakulteti i Drejtësisë përbëhet nga tre departamente:

1. Departamenti i së Drejtës Civile;
2. Departamenti i së Drejtës Publike;
3. Departamenti i së Drejtës Penale.

Sipas të dhënave të vënë në dispozicion nga Institucioni, Fakulteti i Drejtësisë përbëhet nga 21 anëtarë PAE dhe 18 anëtarë PAK, si vijon:

Departamenti i së Drejtës Civile: 7 PAE dhe 8 PAK;
Departamenti i së Drejtës Publike: 7 PAE dhe 4 PAK;
Departamenti i së Drejtës Penale: 7 PAE dhe 6 PAK.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i së Drejtës Civile, për vitin akademik 2017-2018 përbëhet nga 15 anëtarë prej të cilëve 7 PAE dhe 8 PAK, me kualifikimin e mëposhtëm:

- PAE: 3 Dr., dhe 4 Msc.
- PAK: 1 Prof. Dr., 5 Dr. dhe 2 Msc.

Vlerësimi sipas Standardeve


Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	KUB-i si IAL që ofron programin e studimit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", është një institucion jo publik i arsimit të lartë, që është ndërtuar dhe funksionon konform ligjit Nr. 80/2015, dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky IAL ofron programe studimi vetëm në ekonomi dhe drejtësi. KUB-i është i organizuar në tre njësi kryesore, si vijon: Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Drejtësisë dhe Kolegji i Lartë i Studimeve
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy fakultete;	
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka së paku tre njësi bazë, nga të cilat dy departamente;	
Kriteri 4 Fakulteti ose instituti i kërkimit dhe zhvillimit përbëhet nga së paku, tre njësi bazë	

<p>më objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar.</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën shtatë anatere efektive si personel akademik, ndër të cilët të paktën tre duhet të jenë me gradën shkencore doktor.</p>	<p>Profesionale.</p> <p>Fakulteti i Drejtësisë, si njësi kryesore që mbulon Programin Masier i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" përbehet nga tre departamente me nga shtatë pedagogë.</p> <p>Departamentët kanë në përbërje të tyre nga shtatë pedagogë efektive dhe në përbërje të tyre janë tre ose më shumë se tre pedagogë me gradën shkencore doktor.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Departamenti është përgjegjës për realizimin e programit të studimeve Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare",</p> <p>Në Departament janë bërë disa analiza të procesit mësimor, të realizimit të programit, etj, që tregojnë shkallën e përgjegjësisë së tij për programin.</p> <p>Njësitë bazë përfshihen në procesin e rekrutimit të stafit akademik nëpërmjet hartimit të kriterëve të pranimit dhe kushteve të rekrutimit të pedagogëve të rinj.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi i studimit Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", ofrohet nga njësi kryesore Fakulteti i Drejtësisë dhe mbulohet nga njësi bazë Departamenti i së Drejtës Civile. Institucionet janë ngritur dhe funksionojnë konform ligjit dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. • Fakulteti është i organizuar me tre departamente dhe secili departament ka nga shtatë pedagogë, ndër të cilët, tre ose më shumë se tre kanë gradën shkencore Doktor. • Proçedurat e emërimit dhe të përzgjedhjes së stafit akademik, të brndshëm dhe të jashtëm janë të hapura, realizohen sipas disa kriterëve që hartohen nga departamentet dhe konkurseve. <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.</p>	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Stafi dhe personeli i KUB përbëhet nga dy grupe: Personeli akademik dhe Personeli administrativ. Personeli akademik kompozohet nga personeli akademik me kohë të plotë, me kontratë të përhershme pune dhe nga personeli akademik me kohë të pjesshme apo me kontratë. Misioni dhe detyrat e të dy grupeve të personelit të KUB-it është e mirëpërcaktuar në dokumentat e institucionit, në rregulloren dhe statutin e KUB-it. Personeli akademik kryen detyrat dhe funksionet që janë parasgrikuar dhe kërkohen prej tij nga Ligji 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL të RSH".

Personeli akademik është i strukturuar sipas kësaj organigrame:

1. Rektori i KUB-it;
2. Dekanët e dy fakulteteve: Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Ekonomisë, secili fakultet me nga tre departamente;
3. Drejtori i Kolegjit të studimeve të larta profesionale, me dy departamente;
4. Përgjegjësit e Departamenteve (tetë departamente gjithsej);
5. Stafi akademik në çdo departament me nga shtatë pedagogë efektivë secili departament.

Në KUB stafi akademik gëzon lirinë akademike të shprehjes së ideve, të organizimit të mësimi, të përgatitjes së leksioneve, të organizimit të debateve profesionale, etj, konform ligjit. Titullarët e moduleve të programit të studimit: Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", janë si rregull pedagogë efektivë, të punësuar me kohë të plotë.

Personeli administrativ që është në mbështetjt të procesit mësimor të IAL, KUB, përbëhet nga: Administratori, Sekretaria Mësimore, Zyra e Financës, Biblioteka, Sektori mbështetës, dhe sektori shërbimit sanitar. Kontratat e punës të të dy grupeve akademike dhe administrative të institucionit, me institucionin, hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me Kodin e punës në RSH.

Stafi akademik i jashtëm punon në qendra ekonomike dhe biznese, apo institucione të ndryshme, në të cilat kanë eksperiencën e nevojshme në fushën e ekonomisë dhe të së drejtës civile apo tregtare, që përdoret në shërbim të programit të studimit, të tilla si: Gjykata Kushtetuese e RSH, Kompani sigurimesh, Universiteti Bujqësor i Tiranës, etj.

Për programin e studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" janë të angazhuar 11 pedagogë, prej të cilëve 7 PAE dhe 4 PAK, me kualifikimin: PAE: 1 Prof. As. dhe 6 Dr., ndërsa stafi PAK janë 4 me Dr. Si përfundim, stafi akademik që realizon mësimdhënien dhe zbaton programin Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" është i kualifikuar. Fakulteti në të cilin është i instaluar ky program ka eksperiencën e nevojshme dhe është i organizuar dhe strukturuar në përshatje me plotësimin e objektivave strategjike dhe ekzekutimin e programit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat

Për vitin akademik 2017-2018, personeli akademik i programit përbëhet nga 11 anëtarë, 7 PAE dhe 4 PAK. PAE paraqitet me kualifikimin: 1 Prof.As. dhe 6 Dr. PAK paraqitet me kualifikimin: 4 Dr. Në aspektin numerik, raporti PAE/PAK është 63.6 % PAE dhe 63.4 % PAK, ndërsa për sa i takon ngarkesës së mësimdhënies, raporti PAE/PAK është 77.5 % PAE dhe 22.5 % PAK.

Për vitet e tjera akademike që prej akreditimit të parë, të dhënat jepen në tabelat 4 dhe 5 të Anekseve.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

Përbërja e Këshillit Shkencor jepet në tabelën 3 të Anekseve.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Për vitin akademik 2017-2018, personeli akademik i programit përbëhet nga 11 anëtarë, 7 PAE dhe 4 PAK. PAE paraqitet me kualifikimin: 1 Prof.As. dhe 6 Dr. PAK paraqitet me kualifikimin: 4 Dr. Të dhënat e detajuara jepen në tabelat 4 dhe 5 të Anekseve.

Të dhënat sipas seksit

Në këtë program studimi, për vitin akademik 2017-2018 janë të angazhuar 11 anëtarë (7 PAE dhe 4 PAK), prej të cilëve janë 6 meshkuj dhe 5 femra, në raportin 54.5% me 45.5%.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Personeli akademik efektiv (PAE) sipas moshës paraqitet: në moshën 25-35 janë 2 Dr., në moshën 46-55 janë 2 Dr., në moshën 56-65 është 1 Prof. As. dhe 2 Dr.

Personeli akademik me kontratë (PAK) sipas moshës paraqitet: në moshën 25-35 është 1 Dr., në moshën 36-45 është 1 Dr., në moshën 46-55 është 1 Dr., dhe në moshën 56-65 është 1 Dr. Të dhënat paraqiten në tabelat 6.1 dhe 6.2 të Anekseve.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Për të gjithë stafin akademik, efektiv dhe me kohë të pjesshme institucioni ka kontrata të rregullta pune, të firmosura rregullisht, të hartuara në përputhje me kodin e punës dhe me aktet e tjera të KUB-it.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës dhe administrativ është i mjaftueshëm. Për të ka kontrata të rregullta pune të hartuara nga KUB-i dhe në përputhje me kërkesat e Kodit të punës dhe të akteve të tjera të institucionit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, mndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i	Personeli akademik është i angazhuar në përputhje me profilin e pedagogëve në funksion të programit të



<p>institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësitor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>studimit dhe të kërkesave të programit.</p> <p>Fakulteti i Drejtësisë nuk ka personel ndihmës mësitor shkencor, por atij i shërben personeli ndihmës mësitor që ka gjithë KUB-i.</p> <p>Personeli administrativ ndihmës është i punësuar i gjithë me kohë të plotë dhe me kontratë pune të përhershme.</p>
--	---

Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.

<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin programit të studimeve.</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i Fakultetit të Drejtësisë dhe veçanërisht stafi pedagogjik i Departamentit të së Drejtës Civile është plotësisht i angazhuar dhe është njëherësh plotësisht përgjegjës për hartimin e kurrikulës dhe vendimarrjen lidhur me programin e studimit Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare".</p> <p>Departamenti diskuton dhe miraton përmbajtjen e kurrikulave dhe të syllabusave të lëndëve. Po kështu, stafi akademik përcakton edhe kriteret e përzgjedhjes dhe të rekrutimit të pedagogëve të rinj, kriteret e cilat bëhen publike nga strukturat drejtuese të KUB-it.</p> <p>Përzgjedhja e stafit të ri bëhet nga një komision i posaçëm ad-hoc, i cili ngarkohet me administrimin dhe zhvillimin e konkurrimit.</p>
--	---

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, përbën së paku 70 % të ngarkesës së personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Institucioni ndjek procedura transparente dhe në përputhje me kërkesat e ligjit për rekrutimin e personelit. Këto procedura janë të parashikuara dhe të rregulluara edhe me statutin e Institucionit si dhe me rregulloren e brendshme të KUB-it.</p> <p>Personeli efektiv i KUB-it mban dhe realizon 77.5 % të ngarkesës në auditor të programit të studimit Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare".</p> <p>Personeli vlerësohet periodikisht nga shefat e departamenteve, dhe nga strukturat drejtuese të njësisë kryesore. Po kështu, puna dhe efikasiteti i pedagogëve në procesin e mësimdhënies matet dhe vlerësohet periodikisht edhe nga studentët.</p> <p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë organizon rregullisht dy herë në vit pyetësorë të adresuar studentëve për vlerësimin e cilësisë dhe të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Për administrimin e burimeve njerëzore dhe ndjekjen e karrierës së tyre është përgjegjëse zyra e burimeve njerëzore e cila zbaton procedura ligjore për publikimin</p>
---	---

	e kritereve te rekrutimit si dhe për organizimin e konkureseve të pranimit të stafit të ri.
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin akademik "Profesor i Asociuar", ose gradën shkencore Doktor (PhD) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/Modulit në programet e studimeve Master i shkencave ka të paktën gradën shkencore Doktor.</p> <p>Kriteri 3 Titullari i lëndës/Modulit në programet e studimeve Master Profesional ka të paktën gradën shkencore Doktor, ose diplomën Master profesional ose Master i shkencave dhe një përvojë profesionale së paku 5 vjeçare.</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/Rektori, drejtori dhe zv/Drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/Dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit, janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimit.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i Programit të studimit Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", ka gradën shkencore Doktor të mbrojtur në universitete perëndimore.</p> <p>Titullarët e lëndëve dhe të moduleve mbajnë gradën shkencore doktor.</p> <p>Lektorët e lëndëve në këtë program janë me përvojë profesionale në fushën e mësimdhënies dhe me grada dhe tituj akademikë.</p> <p>Drejtimesit e njësisë kryesore dhe drejtimesit akademikë të njësisë bazë që mbulojnë këtë program studimi janë të punësuar me kohë të plotë dhe janë pedagogë efektivë pranë KUB-it.</p> <p>Institucioni ka të garantuar stafin e nevojshëm akademik dhe ndjek praktikat profesionale të studentëve të programit të studimit Master i shkencave. Ngarkesa e numrit të studentëve për një pedagog nuk është shumë e lartë dhe kjo premtion ndjekje normle të praktikave mësimore.</p> <p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm ndërmarrjesh private dhe publike, banka dhe kompani sigurimesh, Dhomën e Tregëtisë dhe institucione të tjera publike që bëjnë të mundur shpërndarjen e studentëve për praktikat mësimore dhe ndjekjen e tyre sipas kërkesave të programit.</p>
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin studimet e ciklit të dytë "Master i shkencave, apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kanë udhëheqës për tezen.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programet studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe mikrotezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencor Doktor,</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikqyr më shumë se pesë studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar dhe më shumë se 10 studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore dhe humane.</p>	<p>Për studentët që ndjekin studimet pranë KUB-it në programin Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregëtare", gjatë përgatitjes së punimit të diplomës, mikrotezave, nga IAL caktohet një drejtues punimi. Drejtuesi i punimit bën udhëheqjen metodike dhe drejtimin e punimit deri në fazën mbrojtëse.</p> <p>Drejtimesit e mikrotezave janë me gradën shkencore Doktor.</p> <p>Për çdo drejtues Kolegji nuk ka caktuar më shumë se 10 studentë njëkohësisht. Drejtimesit në këtë kolegji nuk kanë më shumë se 5 studentë për mbrojtje diplome.</p>
Standardi III.6 - Fusha studimore kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	

<p>Kriteri 1 Fusha studimore kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimit dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza,</p>	<p>Si rregull, drejtuesit e mikrotezave të studentëve të diplomave Master i shkencave, të KUB-it, janë me gradën shkencore Doktor, dhe specialistë të fushave të të drejtës dhe me eksperiencë nga fushat përkatëse.</p> <p>Drejtuesit e mikrotezave kanë njohuri të thelluara dhe të veçanta nga fushat përkatëse, fusha në të cilat përgatiten mikrotezat e studentëve.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personelin ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve shkollore.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë së Kolegjit KUB nuk ka personel ndihmës akademik mësimor-shkencor. Atij i shërben personeli ndihmës që është në nivel kolegji. Nisur nga numri modest i studentëve dhe numri i perdagogëve në këtë kolegji kjo strukturë organizimi dhe kjo mënyrë funksionimi është funksionale.</p> <p>Stafi administrativ është i angazhuar, për të janë të saktësuara detyrat dhe funksionet që duhet të përmbushë secili për realizimin e detyrave dhe të misionit të tij.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi dhe drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Ngarkesa mësimore e stafit akademik të KUB-it bëhet në përputhje me aktet ligjore (respektivisht ligji 80/2015 dhe udhëzimi 20 i MASH-it, plus statuti i KUB-it dhe kontratat individuale të punës).</p> <p>Ngarkesa mësimore llogaritet dhe përfshin të gjithë elementët që parashikojnë aktet e cituara më sipër.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për personelin akademik të përfshirë në program dhe për personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>KUB disponon dhe administron dosjet e plota, me të dhënat të mjaftueshme për të gjithë personelin akademik të përfshirë në programin e studimeve Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare".</p> <p>Dosjet i administron zyra e personelit të KUB-it. Zyra përgjigjet njëkohësisht edhe për administratën dhe burimet njerëzore dhe funksionon mbi bazën e rregullave që ka nxjerrë dhe miratuar Senati Akademik.</p> <p>Dosjet janë të plota dhe në to gjenden të gjitha dokumentat e nevojshme për stafin akademik, si CV, kopje të dokumentave të indentitetit, diplomat e shkollës së lartë, diplomat e gradave dhe titujve akademikë, të gjuhëve të huaja, të kualifikimeve, librezat e punës, dëshmitë e penalitetit, etj.</p>

Kriteret për rekrutimin e stafit akademik bëhen publike. Ato janë të propozuara nga departamenti dhe të miratuara nga Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë përpara se të publikohen dhe shpallen.

Konkluzione:

- KUB ka të punësuar staf akademik të kualifikuar, me grada dhe tituj shkencorë, të përshtatshëm për kërkesat dhe nivelin e programit të studimit Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare".
- Institucioni respekton dhe zbaton standardet dhe kërkesat e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore të MARS lidhur me ngarkesën e një pedagogu me orë në auditor dhe angazhime të tjera, si dhe me numrin e studentëve që duhet të drejtojë një pedagog për punime të mikrotezës dhe të diplomave.
- Stafi akademik ka përgatitjen e duhur akademike dhe shkencore në fushat në të cilat ai është angazhuar dhe ka gjithashtu edhe eksperiencën e nevojshme profesionale në fushat respektive. Stafi akademik ndihmohet dhe mbështetet nga stafi ndihmës mësimor shkencor i Kolegjit dhe nga stafi administrativ.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Kolegji Universitar "I Biznesit" është i vendosur në një godinë të veçantë në lagjen Laprakë të qytetit të Tiranës, në një objekt unik, të përshtatshëm dhe funksional për të përmbushur misionin dhe objektivat e veta në fushën akademike dhe mësimore.

KUB-i posedon ambjentet e nevojshme si: salla mësimore të pajisura me sistemet kompjuter dhe videoprojektor, ambjentet për personelin akademik, për atë administrativ, ambjentet për bibliotekën, për laboratorët e informatikës, për shërbimet financiare dhe të brendëshme, për sekretarinë dhe administratën, për personelin dhe arkivën, etj.

~~KUB i ka një bibliotekë në shërbim të studentëve, me rreth 70 metra katrore, me rreth 5000 kopje librash dhe tituj, që ka kapacitet 40 persona të ulur në tavolinë, me akses në internet 24 orë, të disponueshme nga dita e hënë në të premte në orarin 08:30-15:00 dhe 16:00-19:00, me lidhje dhe mundësi shkëmbimi të informacionit edhe me biblioteka të tjera të institucioneve akademike dhe kërkimore në qytetin e Tiranës, si dhe me bibliotekën kombëtare. Studentët dhe pedagogët kanë akses të pakufizuar në një sërë adresash elektronike, të cilat ofrohen prej KUB-it gratis për studentët. Në bibliotekë gjenden njëherësh edhe tituj revista dhe burime të tjera nga fusha e jurisprudencës, nga fushat e biznesit, të ekonomisë, kontabilitetit dhe kulturës.~~

KUB-i ka në dispozicion të procesit mësimor dhe të programit të studimit Mastr i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" edhe një laborator të informatikës me 26 komplete kompjutera dhe programet e nevojshme në të cilat zhvillohen lëndët specifike të programit, si hyrje në informatikë apo lëndë të tjera të avancuara si dhe janë në dispozicion të studentëve për punimet e tyre të kursit, për punimin e mikrotezave si dhe për punë të pavarura. Po kështu ka në dispozicion edhe njëmjedis të quajtur internet-kafe, me mbi 100 metra katëror.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit:

- Auditorë/salla mësimi për leksione/seminare, të pajisura me videoprojektorë dhe laptop;
- Mjedise për personelin akademik;
- Mjedise për personelin administrativ;
- Salla për aktivitete promovuese;
- Laborator informatike;
- Mjedise internet-kafe;
- Sallë e dedikuar për Bibliotekën;
- Mjedis për fotokopjime, librari, etj;
- Arkivë/magazinë;
- Shkallë emergjence;
- Ambjent parkimi.

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ Kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qendrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
Standardi II. 5- Institucioni vë siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vëndndodhej të përhershme, që nënkupton mjedis qëndror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore.	KUB-i ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe në shërbim të programit të studimit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare".
Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet.	Ka një kontratë të marrjes me qera të ambjenteve që ka në dispozicion për më shumë se 6 vjet.
Kriteri 3 Në se programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni	Programi i studimit Master i shkencave në " Edrejtë civile dhe tregtare" zhvillohet në të njëjtat mjedise



<p>siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>me të gjitha programet e tjera të të njëjtit institucion.</p> <p>KUB-i ka marrëveshje të nënshkruara me mjaft studio ligjore, si dhe me studio të tjera profesionale nga fusha e avokatisë apo e kontabilitetit për realizimin e praktikave profesionale të studentëve.</p>
--	--

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Nëpërmjet bibliotekës, KUB-i vë në dispozicion të studentëve, tekstet mësimore të parashikuara si literaturë bazë në syllabusat e lëndëve dhe të programeve mesimore.</p> <p>Fondi i bibliotekës që është kryesisht në gjuhën shqipe, ka gjithashtu edhe botime në gjuhë të huaja apo periodikë të tjetër.</p> <p>Fondi i bibliotekës pasurohet dhe shtohet periodikisht edhe me botime të reja nga fushat e të drejtës, nga fusha sociale si dhe nga fusha e biznesit dhe e financës dhe kontabilitetit.</p> <p>Biblioteka është në shërbim të procesit mësimor dhe në dispozicion të studentëve dhe të pedagogëve. Në të ka mbi 5000 ekzemplarë tituj librash dhe revista të fushës. Koha përgjatë të cilës biblioteka është e hapur është funksionale dhe e mjaftueshme për nevojat e studentëve.</p> <p>Në dispozicion të studentëve dhetë stafit akademik janë edhe një sërë adresash elektronike në të cilat studentët kanë akses pa kufi dhe gratis, dhe që mund të përdoren për punë të pavarur, për punë studimore, për hartimin e punimeve të kursit, të mikrotezave dhe të detyrimeve të tjera të shkollës.</p> <p>Fondi i bibliotekës pasurohet me tituj dhe botime të reja nga fusha. Institucioni investon shuma modeste për pasurimin periodik të saj.</p>
--	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë, në të cilin është programi i studimit Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" nuk ka në dispozicion laboratorë të veçantë për nevojat e tij, por përdor dhe ka akses të plotë, pa kufizim dhe gjithë kohës, laboratorët e informatikës që janë në shërbim të fakultetit të Ekonomisë dhe programeve të tjera të studimit.</p>
---	---

Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Jashtë kohës së orareve mësimore, laboratorët përdoren dhe shfrytëzohen nga të gjithë studentët e KUB-it.

KUB-i ka nënshkruar 43 marrëveshje gjithsej me qendra të tjera të arsimit të lartë, me studio profesionale, me kompani private, me studio avokatore, me studio legale, etj, me të cilat mundëson realizimin e praktikave mësimore të studentëve të programit të studimit Master i shkencave.

Konkluzione:

- KUB-i ka mjedise dhe ambjente të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor, në përmbushje të programit të studimit Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare",
- Në ambjentet e institucionit ka internet që u ofrohet studentëve gjatë 24 orëve, për nevojat e procesit mësimor dhe të programit të studimit.
- Ka të garantuar gjithë infrastrukturën e nevojshme që nuk lejojnë ndërprerjen e procesit mësimor në raste të avarive për ndërprerje të energjisë elektrike apo shkaqe të tjera.
- Biblioteka është funksionale dhe e pasur me një numër të madh titujsh dhe botimesh, të cilat pasurohen periodikisht.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Burimet financiare të Kolegjit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe aktivitetet tjera tregtare të përmendura më poshtë. Të gjitha të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. Në rang Kolegji ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare dhe kontrollin e tyre të përmendura më poshtë tek kriteret. Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor (për të gjitha vitet e kaluara) të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm. Në raport ka të dhëna të hollesishme për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shendetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative, etj. Bazuar mbi kriteret e standardeve shtetërore të cilësisë ky Institucion ia ka dalë me sukses që të mbulojë të gjitha kostot financiare dhe të gjitha shërbimet e kërkuara.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

Burimet financiare janë ato që lidhen me tarifat e shkollimit të studentëve. Rreth 1/3 e këtyre burimeve të të ardhurave shpenzohet për qiranë e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me të

(mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja etj.). Pjesë tjetër e burimeve të të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin internet, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit. Të dhënat paraqiten në tabelën 9 të Anekseve.

Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të KUB-it, të leshuar nga QKB.

Në mënyrë të përmbledhur të ardhurat dhe financimet e ndryshme të KUB-it, për gjashtë vitet e fundit, në strukturë, paraqiten në tabelën 8 të Anekseve.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Në raportin vjetor ekonomik dhe financiar të KUB-it është specifikuar edhe kostoja për çdo student sipas programeve të studimeve. Për programin e studimeve Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", kostoja e çdo studenti jepet në tabelën 11 të Anekseve.

Ndryshimi i kuotës ndër vite është në funksion të dy parametrave: shpenzime gjithsej dhe numri i studentëve të rekrutuar dhe të rregjistruar apo të transferuar për studime në KUB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Pasqyrat dhe raportet financiare të KUB-it janë rregullisht të hartuara nga një profesionist i fushës dhe të audituara rregullisht nga një ekspert kontabël i rregjistruar. Raportet vjetore financiare vjetore të certifikuara janë të depozituara rregullisht në QKB dhe në administratën tatimore.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Një nga pasqyrat financiare të prezantuara në raportin vjetor, është bilanci i gjendjes financiare dhe i performancës financiare në të cilën prezantohen mjetet dhe burimet, të drejtat dhe detyrimet e KUB-it, të cilat janë korrekte dhe nuk paraqesin asnjë problem dhe vështirësi financiare që të cënojë procesin e mësimdhënies dhe të realizimit të programit.
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Në raport janë të identifikuar burimet financiare si dhe fakti që KUB-i paguan rregullisht pagat e punës të stafit akademik dhe ndihmës si dhe të gjitha detyrimet e tjera financiare.
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot	Pasqyrat e performancës financiare janë hartuar në përputhje me kërkesat e standardeve kombëtare të kontabilitetit dhe të ligjit për shoqëritë tregëtare.

<p>operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p>	<p>Pasqyrat financiare janë të detajuara, për gjëndjen dhe performancën financiare, për kapitalin dhe kontributet apo dinamikën e kapitalit, për cash flow dhe rrjedhjet e tjera të arkes, për të drejtat dhe detyrimet, për shpenzimet e qerasë dhe të tjera detyrime, për amortizimet dhe detyruimet ndaj shtetit, etj.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Gjendja financiare e KUB-it paraqitet e qëndrueshme dhe financiarisht institucioni garanton mbajtjen dhe realizimin e programit të studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare".</p>
<p><u>Konkluzione:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjendja financiare e KUB-it paraqitet e qëndrueshme dhe financiarisht institucioni garanton mbajtjen dhe realizimin e programit të studimeve Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare". • Institucioni dokumenton rregullisht gjëndjen e tij financiare dhe harton çdo vit kalendarik një raport të gjendjes financiare të shoqëruar me pasqyrat dhe anekset e performancës financiare si dhe të drejtat dhe detyrimet e KUB-it. <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e NJSBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në anketimet, studentët kanë shprehur shqetësimet lidhur me:

- penalizimin për shkak të mungesave dhe të mosndjekjes së studentëve të leksioneve e seminareve;
- hapësirave të kufizuara për studim;
- mungesa e shërbimit të sekretarisë online;
- mospërfshirjen e studentëve në veprimtari kërkimore;
- numrin e kufizuar të titujve të librave në gjuhën shqipe.

Këto shqetësime janë relatuar nga NJSBC dhe janë trajtuar edhe nga Rektorati.

Grupi i ekspertëve të jashtëm, ekzaminoi me kujdes, rezultatet dhe kalueshmërinë e studentëve, në shkallë Programi, Fakulteti dhe Kolegji. Konstatojmë se:

- institucioni analizon kalueshmërinë dhe cilësinë;
- ka luhatje të konsiderueshme të kalueshmërisë midis studentëve të fakulteteve të ndryshme;

- ka luhatje të konsiderueshme të kalueshmërisë dhe notës mesatare, midis studentëve të vitit të parë dhe atyre të viteve të larta, në të njëjtin program.

Në raportin e vetëvlerësimit, listohen detyrat dhe funksionet e NJSBC, të cilat janë të sanksionuara në dokumentat bazë të Institucionit. Rezulton se misioni dhe detyrimet e NJSBC janë më të gjëra dhe se veprimtaria e Zyrës është e kufizuar. Gjykohet se në përbërje të Njësisë të Sigurimit të Cilësisë duhet të dominojnë stafi me eksperiencë më të gjatë pune.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët:
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj.

NJSBC ka organizuar rregullisht intervista me studentët e programit të studimeve Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" lidhur me testimin e programit dhe të cilësisë së mësimdhënies. Janë intervistuar studentë të të dy viteve të studimit të programit, nga të cilët 54 % në semestrin e parë dhe 75 % në semestrin e dytë. Po kështu janë anketuar edhe rreth 80 % e pedagogëve.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Rekomandimet e NJSBC kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes së pedagogëve, që rekrutimi të jetë një proces transparent, të pasurohet biblioteka e institucionit me tituj dhe botime të reja, të fushave të të drejtës dhe me botime të kohëve të fundit, të gjuhës shqipe dhe ose në gjuhë të huaj.

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

NJSBC ka zhvilluar mbledhje dhe ka garantuar funksionimin sistematik të saj. Është mbledhur disa herë dhe për konkluzionet dhe materialet që ka diskutuar ka informuar rregullisht organet vendimmarrëse të KUB-it.

- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Institucioni ka kryer vetëvlerësime lidhur me përzgjedhjen e temave të diplomave të studentëve të programit Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", garantimin e takimeve periodike me studentët e kësaj diplome, standardizimin e raportimit të pedagogëve të KUB-it për programin në fjalë, si dhe pasurimin dhe përditësimin e syllabusave.

- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Përmirësimi i cilësisë synon të realizohet nëpërmjet zbatimit me korrektesë të rregulloreve të vlerësimit të brendshëm, hartimit dhe zbatimit të një plani vjetor të vlerësimit të brendshëm, përfshirjes së Departamentit në këtë proces, monitorimi në mënyrë periodike si dhe gjithëpërfshirëse.

- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Vendim i Senatit Akademik Nr. 74, datë 26.07.2017
 - Vendim i Senatit Akademik Nr. 47, datë 14.10.2016
 - Vendim i Senatit Akademik Nr. 36, datë 16.10.2015

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); b. Dëgjime në auditor; c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të 	<p>KUB-i ka përdorur disa mënyra për vlerësimin dhe matjen e ecurisë së programit të studimeve Mastr i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", si intervista me pedagogët, pyetësorë me studentët, analiza periodike vjetore për ecurinë e procesit mësimor dhe realizimin e programit, etj.</p> <p>Për vitin e fundit akademik janë pyetur dhe kanë shprehur opinionin e tyre 80 % e pedagogëve të angazhuar në programin në fjalë.</p> <p>Janë anketuar 54 % e studentëve të programit në semestrin e parë dhe janë anketuar 75 % e studentëve në semestrin e dytë, për të shprehur opinionin e tyre lidhur me ecurinë dhe vlerësimin për programin.</p> <p>Departamentet dhe departamenti i së drejtës civile që mbulon programin nuk është i përfshirë në mënyrë të drejtëpërdrejtë për vlerësimin e cilësisë së brendshme, por rezultatet dhe opinionet lidhur me cilësinë ky departament i merr nga NJSBC.</p> <p>KUB-i vlerëson se edhe fakti që shumica absolute e studentëve që kanë përfunduar studimet e nivelit bachelor, kanë zgjedhur të vijojnë studimet e nivelit Master në të njëjtin kolegji, tregon se studentët kanë shkallë të lartë të vlerësimit të tyre për institucionin, programin dhe mësimdhënien. Opinioni ynështë se nga kjo nuk mund të arrihet në të njëjtin përfundim, duke u nisur nga natyra e studimeve dhe e studentëve, nga shkalla e njohjes apo nga informacioni apo kriteret që përdorin shkollat e tjera të larta.</p> <p>Po kështu KUB-i organizon edhe pyetësore me pedagogët me të cilët teston nivelin e plotësisë të kushteve të punës për stafin dhe kushtet e</p>

<p>analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>a. Etj.</p>	<p>studimit për studentët.</p> <p>Studentët shprehën opinion dhe vlerësim pozitiv lidhur me angazhimin e tyre dhe ngarkesën në procesin mësimor dhe në realizimin apo ekzekutimin e programit mësimor.</p>
--	--

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

Institucioni ka botuar dhe boton broshura të karakterit informues për studentët por jo broshura që kanë s objekt të tyre kontrollin e brendshëm të cilësisë apo problematikat që rrok kjo temë.

Po kështu KUB-i ka inforacion që ka të bëjë me informimin e studentëve si dhe përdor edhe mediat vizive dhe të shkruara për të bërë publikë kushtet dhe avantazhet e studimeve në KUB, por jo që jkanë të bëjnë me kontrollin e cilësisë dhe me vlerësimin e brendshëm.

Institucioni nuk ka të publikuar për akses të të gjithë studentëve dhe stafit akademik informacionet lidhur me vlerësimin e brendshëm.

Pedagoget nuk i njohin gjithnjë opinionet e shprehura nga studentët në anketimet periodike që u bëhen atyre.

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Institucioni nuk ka kryer ndonjë analizë të posaçme vjetore ku të ketë marrë në shqyrtim programin e studimeve Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" por është mjaftuar me analizën që është kryer në bazë institucioni, meqenëse bëhet fjalë për një IAL me numër të limituar studentësh dhe stafi akademik.

Edhe Fakulteti i Drejtësisë si njësi kryesore nuk ka kryer analizë të posaçme vjetore për programet që janë profilin juridik, përfshi edhe programet Master.

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Institucioni është akredituar institucionalisht për herë të parë në vitin 2012, me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe shkencës Nr. 557, si Akademi Profesionale e Biznesit, sot KUB.

Në vitin 2017, KUB-i është akredituar institucionalisht për një periudhë kohore 4 vjeçare nga ASCAL dhe QAA.

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Institucioni përdor kalimin në nivele të ndryshme të procesit të hartimit, miratimit dhe zbatimit të programeve të studimit. Po kështu edhe dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me procesin e mësimdhënies, si syllabusat, plane mësimore, procedurat për hatimin dhe miratimin e tezave të provimit, etj kalojnë në disa nivele dhe kjo procedurë shërben si një lloj filtri për të garantuar dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë.

NJSBC kryen kontrole periodike me kampione studentësh dhe realizon herëpashere pyetësore lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe me funksionimin korrekt institucional dhe të programit të studimit, Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare".

NJSBC ka përdorur metoda të ndryshme për të grumbulluar informacionin e nevojshëm dhe për të matur nivelin e cilësisë në mësimdhënie. Forma të tilla si anketimet anonime të studentëve, vizitat në auditorin emësimeve, diskutimet mbi ekuivalentimin e nivelit të studimeve për studentët që kanë ardhur në KUB me transferim, etj, i kanë shërbyer përmirësimit të cilësisë.

NJSBC ka zhvilluar edhe takime me stafin apo seminare që synojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e stafit akademik lidhur me nivelin dhe cilësinë e realizimit dhe të ekzekutimit të programit.

Konkluzione:

- KUB në veprimtarinë e tij synon ndjekjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të realizimit të programit.
- Përdor në mënyrë periodike forma dhe metoda alternativa për të grumbulluar informacionin dhe për të matur nivelin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, ka një njësi të posaçme që ndjek këtë problem, e cila informon dhe njofton të gjithë stafin dhe organet vendimmarrëse lidhur me problemet që konstaton dhe atëçfarë propozon dhe sugjeron NJSBC.
- Jo gjithnjë dhe jo i gjithë stafi akademik njih rregullisht opinionet e shprehura nga studentët lidhur me vlerësimin e brendshëm dhe cilësinë e realizimit të programit.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen kryesisht.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", ofrohet krahas programeve të tjera të studimit që realizon Fakulteti i Drejtësisë, në Kolegji Universitar i Biznesit. Programi i studimit "E drejtë civile dhe tregtare" ka si objektiv kryesor të përgatisë ekonomistë të profilit juridik, me njohuri bashkëkohore, të aftë të punojnë në kompani apo në institucione me njohuri të mjaftueshme për t'u adaptuar edhe si specialistë në fushën e së drejtës shoqërore, dhe të të drejtës së tregut, të aftë të japin konsulencën e nevojshme juridike dhe profesionale në strukturat publike dhe jo publike, të aftë të ndërtojnë karrierë të pavarur profesionale, dhe të përshtaten në të gjitha nevojat e bizneseve shqiptare apo të huaja kur ato kanë nevojë për shërbime të karakterit juridik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi


Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" është hapur me VKM Nr. 651, datë 14.09.2011 dhe është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 545, datë 13.11.2012, në bazë të Vendimit Nr.394, dt.26.10.2012 të Këshillit të Akreditimit, si program studimi i ciklit të dytë pranë Fakultetit të Drejtësisë.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" është program studimi i nivelit të dytë (Master). Ai është i organizuar në dy vite akademike me nga 60 ECTS në vit, për një total prej 120 ECTS. Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese të programit janë të organizuara në 16 lëndë. Viti akademik është organizuar në semestra dhe çdo semestër është konceptuar dhe organizuar nga 15 javë mësimore në auditor.

- 1 vit akademik ka: 30 javë mësimore në auditor, ose 60 kredite
- 1 Semestër ka: 15 javë mësimore në auditor, ose 30 kredite
- 1 ECTS: 25 orë mësimore të studentit
- 1 orë mësimore: 50'

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë



Programi i studimit është organizuar në katër semestra, për dy vite. Në të përfshihen lëndët, modulet, kreditet dhe orët për çdo kredit, në auditor dhe jashtë auditorit. Po kështu në program janë përcaktuar edhe materialet mbështetëse dhe literatura për secilën lëndë. Në vitin e parë janë 59 ECTS dhe në vitin e dytë 61 ECTS. Shpërndarja e lëndeve sipas viteve dhe semestrave, është bërë në përputhje me një filozofi të të mësuarit që kalon nga formimi i përgjithshëm te formimi bazë profesional dhe formimi i veçantë profesional, të harmonizuara me disiplinat mbështetëse. Plani mësimor paraqitet në tabelën 14 të Anekseve. Programi i studimit dhe kreditet janë të transferueshme dhe Kolegji pranon studentë që vijnë nga programe të njëjta të universiteteve të tjera, si dhe studentët e këtij programi mund të transferohen në fakultete të tjera të shkollave të tjera të larta.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit (sipas RVB):

- Leksionet: rreth 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Seminaret: rreth 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Praktika Profesionale: 10 orë në auditor dhe 70 orë punë e pavarur e studentit
- Punim Diplome: 10 orë në auditor

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Institucioni ka bërë ndryshime dhe përmirësime të programit të studimeve në krahasim me programin e licensuar. Përmirësimet nuk kanë prekur dhe nuk përbëjnë ndryshime rrënjësore. Ato e kanë përmirësuar dhe përditësuar atë.

Ndryshimet në planin mësimor krahasuar me programin e licensuar jepen në tabelën 15 të Anekseve.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Lëndët dhe modulet mbulohen nga pedagogë dhe staf akademik efektiv dhe i jashtëm me tituj dhe grada shkencore, të cilët kanë të programuar orët në auditor dhe orët janë të ndara në orë leksionesh dhe orë për seminare, diskutime, punë të drejtuar dhe ose debate në auditor.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik jepen në tabelat 16.1-16.5 të Anekseve.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve



Për secilën lëndë, Departamenti posedon syllabusat respektive. Syllabuset janë hartuar nga përgjegjësit e lëndës dhe në konsultim me departamentin. Në programe (Syllabus) përfshihen temat,

detyrimet e studentëve, koha e përmbushjes së tyre, literatura bazë dhe ajo plotësuese, ndarja e vlerësimit në të vazhduar dhe në fund të përfundimit të programit të lëndës, etj.

- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Ristrukturimi i planeve mësimore sipas Udhëzimit 15

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi është licensuar me VKM Nr. 651, datë 14.09.2011 dhe akredituar me UMASH Nr. 545, datë 13.11.2012. Programi është i akredituar dhe tani i nënshtrohet riakreditimit. Sot KUB, në konformitet me urdhërin e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Nr. 39, datë 30.01.2018, ky institucion ka ndërruar statusin dhe emërtimin dhe sot është shndërruar në Kolegji Universitar "I Biznesit", shkurt, KUB.</p>
	<p>Me vendimin numër 100, datë 10.11.2017, të Bordit të Akreditimit, pranë ASCAL, KUB ka marrë akreditimin institucional për 4 vite me propozim të QAA. Të gjitha programet e ofruara nga KUB janë të akredituara nga Ministria e Arsimit. Me urdhërin Nr. 500, të datës 18.12.2012, janë akredituar programet e studimit Bachelor në Drejtësi, Bachelor në Ekonomi me tre profile si dhe programet Master Profesional në Kontabilitet Financë dhe në Administrim Biznesi. Po kështu, me urdhërin Nr. 553, të datës 23.11.2016, të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, është akredituar edhe programi tjetër i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Kontabilitet Financë dhe me urdhërin Nr. 562, të datës 30.11.2016, është akredituar programi tjetër i ciklit të dytë Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi. KUB-i ofron programe studimi Bachelor në Drejtësi me kohëzgjatje tre vite akademike, në përfundim të të cilit studenti fiton 120 kredite.</p> <p>Numri i krediteve që grumbullohet për çdo vit akademik është 60 ECTS dhe për gjithë programin dy vjeçar, Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", të studimit është 120 ECTS.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;

Kriteri 3 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;

Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;

Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

Kriteri 6 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7 Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Programi i studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", ofron njohuri të thelluara teorike dhe praktike si dhe trajnimin e nevojshëm për kërkim të pavarur të studentëve në fushën e të drejtës civile si dhe në fushën e të drejtës tregëtare, që janë dy fusha me formim specifik.

Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që parashikon zgjerimin e njohurive të marra nga niveli Bachelor në Drejtësi si dhe thellim të njohurive në disiplina të avancuara dhe të atyre që kanë të bëjnë me njohuri të karakterit bazë dhe të lëndëve të formimit bazë të nivelit bachelor.

Studentët që përfundojnë me sukses provimet e lëndëve të parashikuara në programin "E drejtë civile dhe tregtare" fitojnë kompetencën e nevojshme dhe ofrohen si specialistë në fusha të ndryshme të të drejtës, mund të punësohen në vende pune si: ekspert të të drejtës dhe këshilltarë juridike pranë ndërmarrjeve, institucioneve apo kompanive kombëtare apo ndërkombëtare. Po kështu ata do të mund të ofrohen edhe si ekspertë ose drejtues në studiot e mëdha juridike kombëtare dhe ndërkombëtare, apo në zyrat e burimeve njerëzore.

Të diplomuarit në programin e studimeve të ciklit të dytë Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", plotësojnë kushtet dhe kreditet që të mund të pranohen në studimet e ciklit të tretë të doktoraturës, në institucionet që kanë shkollë të doktoraturës.

Programi i studimit jep njohuri në fushën profesionale si dhe jep shanse të mëdha për tu integruar në profesionin e avokatit që është profesion i rregulluar, ashtu sikurse edhe kontabilistët dhe profesionet e tjera të rregulluara.

Në strukturën e lëndëve të programit ka lëndë që duhet të zënë më shumë vend në program, apo module që në gjykimin tonë i kërkon më shumë profili i programit, si e drejta tregëtare, apo lëndë të ngjashme.

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin

Programi i studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" është kompozuar në mënyrë të tillë që me të të arrihen ato objektiva që KUB-i ka pasur dhe deklaruar që

<p>ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arrijtjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>në momentin e liçensimit të programit.</p> <p>Metodat e vlerësimit të studentëve në këtë program janë të ndryshme, të vazhduara dhe përfundimtare. Ato janë me shkrim, me teste, me provime dhe me goje, apo me vlerësime të pjesshme të lidhura me vijueshmerinë dhe me angazhimin e studentëve përgjatë ndjkejes së programit të studimeve.</p> <p>Si rregull, KUB-i përdor këto tre metoda të vlerësimit dhe matjes së dijeve të studentëve: vlerësim i vazhduar (me 10 pikë), vlerësim me provime të pjesshme, me 20-30 pikë dhe vlerësimi me provimin përfundimtar, me 50-60 pikë.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi mbështetet në praktikat më të mira kombëtare dhe rajonale. Ai është hartuar në mbështetje të programeve të shkollave më të mira në vëndin tonë, të cilat nga ana e tyre janë mbështetur edhe në përvojat dhe praktikat europiane.</p> <p>KUB-i ka organizuar debate dhe leksione të hapura me pedagogë dhe personalistete të fushës së jurisprudencës, me përvojë ndërkombëtare.</p> <p>Nga kontaktet me pedagogët dhe stafin në përgjithësi, u evidentua konkluzioni se ky program ka marrë në konsideratë edhe traditën ligjore shqiptare dhe zakonet me të mira të vëndit tonë.</p> <p>Në programin e studimit "E drejtë civile dhe tregtare" ka disa lëndë nga e drejta europiane, e drejta e krahasuar europiane apo e drejta tregtare europiane.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Programi i studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", është ndërtuar në mënyrë të tillë që ofron studime të thelluara, teorike dhe praktike, në fushat e të drejtës, shoqërore, në fushën e të drejtës tregëtare, të të drejtës administrative, por edhe në fushat e të drejtave të krahasuara, dhe të atyre europiane, etj.</p> <p>Programi shkon në harmoni me profilin e KUB-it, i cili është i fokusuar në fushën e biznesit, të biznesit të aplikuar, të praktikave në fushën e biznesit, por edhe në fushën e</p>

<p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>studimeve teorike, sikurse është programi në fjalë.</p> <p>Programi parashikon që studentët të zhvillojnë edhe orë jashtë institucionit që kanë të bëjnë me praktikat e tyre mësimore apo me kontaktet me profesionistët e fushës.</p> <p>Profili i Fakultetit të Drejtësisë është ndërtuar në përputhje me kërkesat e programit.</p> <p>Ndërkohë, stafi akademik ka nivelin e duhur akademik dhe është i angazhuar përveç procesit të zakonshëm të mësimdhënies edhe në veprimtari kërkimore dhe shkencore. Për këtë mund të përmendim një sërë konferencash të karakterit shkencor, në të cilat ka qënë i angazhuar gjithë stafi i programit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare".</p> <p>Po kështu pedagogët dhe stafi në përgjithësi i angazhuar në këtë program dhe i angazhuar edhe në programe të tjera është i përfshirë edhe në veprimtari botuese dhe publikime.</p>
	<p>Shpërndarja e orëve dhe e ngarkesës mësimore midis lëndëve është e njëjtë dhe kjo nuk shpreh në të vertetë rolin e ndryshëm që kanë në formimin profesional të lëndëve të ndryshme.</p>

Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Nga informacioni që kërkua dhe na u vu në dispozicion prej Fakultetit të Drejtësisë të KUB-it na rezulton se në këtë IAL nuk ka programe studimi të ciklit të dytë "Master Profesional".</p>
---	---

Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; 	<p>Institucioni nuk ka ndonjë studim të përditësuar të tregut të punës, të nevojave dhe të kërkesave specifike të ofruesve të vendeve të punës për të diplomuarit në programin e studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare".</p> <p>Fakulteti i Drejtësisë ndjek ndryshimet e mjedisit institucional dhe ndryshimet në tregun e punës të këtij profili dhe bën herë pas here ndryshimet dhe reflektimet e nevojshme,</p> <p>Statistikisht institucioni deklaroi se 85 % e të diplomuarëve në këtë program studimi janë</p>
---	--

<p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>punësuar në ndërmarrje dhe institucione të ndryshme kombëtare dhe lokale.</p>
---	--


Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregëtare", ruan dhe respekton traditën kombëtare. Në syllabusedhe në program ka lëndë dhe tema mbi kulturën dhe traditën në të drejtën tonë kombëtare dhe zakonore.</p> <p>Ka mjaft tema dhe leksione të hapura që i promovojnë dhe i respektojnë vlerat dhe traditat në shërbim të interesit kombëtar.</p>
--	---

Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi i studimeve Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregëtare", është organizuar në dy vite akademike; me 120 kredite europiane, me respektivisht 59 kredite në vitin e parë dhe 61 kredite në vitin e dytë, me kredite ECTS të specifikuar për secilën lëndë. Në pjesën përshkrimore të këtij kapitulli shpjegohen në mënyrë të detajuar kreditet për secilin vit dhe për secilën lëndë.</p> <p>Programi ka gjithsej 13 lëndë, ose module dhe mbrojtja e punimit të diplomës, mikroteza, ka 30 kredite. Ajo drejtohet nga një pedagog me grada shkencore për çdo student, konform ligjit dhe kërkesave.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>N/A</p>

Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve



<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Syllabuset dhe gjithçka që ka të bëjë me lëndët, modulet dhe leksionet, për programin e studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" janë të disponueshme dhe mund të përdoren dhe të gjënden lehtësisht prej studentëve.</p> <p>Fakulteti i Drejtësisë dhe Departamenti i të drejtës civile e kanë bërë praktikë pune që studentëve tju vënë në dispozicion një kopje të syllabusit të plotë të lëndës, që në fillim të procesit mësimor.</p> <p>KUB-i, Fakulteti i Drejtësisë, si dhe Departamenti që mbulon programin e studimeve, e kanë bërë praktikë të rregullt pune që u ofrojnë studentëve edhe gjithë materialet e tjera që kanë të bëjnë me ligjet, me udhëzimet dhe me materiale të tjera të karakterit ligjor por që kanë vlera didaktike.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>KUB-i pajis rregullisht me diplomën përkatëse, të miratuar, të gjithë studentët që përmbushin me sukses të gjitha detyrimet e shkollës së lartë dhe të programit të studimeve.</p> <p>Forma dhe formati i diplomës janë të miratuara nga Senati Akademik, në përputhje me udhëzimet e MASR dhe të ligjit.</p> <p>Në përfundim të studimeve studentët punojnë për një mikrotezë, që përfaqëson një punë të pavarur, që zgjat gati tre-katër muaj kohë, që është nën drejtimin e pedagogut, për të cilën në program janë paraparë 30 kredite.</p>
<p><u>Konkluzione:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Programet e ofruara nga KUB-i janë në përputhje me qëllimin e tij. • Programi Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" është në të njëjtën linjë me misionin dhe profilin e KUB-it dhe të Fakultetit të Drejtësisë të tij. • Programi është në harmoni me legjislacionin vendas për programet e studimeve të ciklit të tretë, si dhe me legjislacionin për profesionet e rregulluara, sikurse janë profesionet e avokatit, të kontabilistit, profesione me të cilët janë të lidhura diplomat e programit në fjalë. • Programi është aktual, në përputhje me kërkesat e tregut dhe në harmoni me zhvillimet legjislative dhe me proceset integruese të vendit. • Programi mban në konsideratë vlerat dhe traditat kombëtare dhe historike të fushës. • Në program duhet të përfshihen edhe lëndë që kanë më tepër lidhje me profilin e 	

programit, si e drejta tregtare.

- Ndarja e vëllimit të orëve në mënyrë të barabartë midis lëndëve nuk shpreh rolin dhe rëndësinë e ndryshme që kanë në formimin profesional të studenteve lende dhe disiplina të ndryshme.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen kryesisht.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia është e organizuar me leksione, seminare, punime në laboratore dhe praktika mësimore. Pedagogët, në fillim të çdo semestri, hartojnë programin e lëndëve, ku përfshihen, qëllimet, objektivat, koha e realizimit, kreditet, temat që do trajtohen dhe plani kalendar i zhvillimit të orëve mësimore. Metodatat e mësimdhënies janë ndërvepruese, duke vënë në epiqëndër studentin. Kujdes i veçantë tregohet për përmirësimin e teknologjisë së mësimdhënies, për përdorimin e metodave interaktive, përdorimin e informatikës, të internetit dhe të mjeteve të tjera audivizive. Kontrolli i njohurive realizohet me forma të ndryshme, të ndërthurura dhe të shtrira në kohë, përgjatë semestrit dhe viti akademik. Çdo lëndë kontrollohet dhe vlerësohet nëpërmjet dy elementëve kryesore: vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi në fund të semestrit, me provimin e lëndës. Vlerësimi i vazhduar realizohet nga detyrat e kontrollit, nga punimet e kursit, nga kolokiumet, nga pjesmarrja dhe aktivizimi.

Format e kontrollit të njohurive

Institucioni përdor disa forma të kontrollit të dijeve të studentëve të Programit të studimeve Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", si vlerësimi për pjesëmarrje në orët e leksioneve dhe të seminareve, e cilësuar dhe e bërë e ditur kjo edhe për studentët në syllabusat e lendeve, vlerësimet e pjesshme me provime të pjesshme në përfundim të javës së gjashtë ose të shtatë të studimeve, vlerësimi me punime kursi si dhe vlerësimi përfundimtar me provimin final të çdo lënde. (Tabela 20 e Anekseve)

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Të dhëna mbi aktivizimin e studentëve paraqiten në tabelën 21 të Anekseve.

Gjykojmë që:

- Ndarja e orëve të mësimimit në mënyrë të barabartë midis lëndëve nuk është e drejtë. Nuk janë dhe nuk mund të jenë të gjitha lëndët dhe modulet të të njëjtës rëndësi për programin e studimit. Për më tepër, duke i ndarë orët e mësimimit në peshë të barabartë nuk krijohet

mundësia e përparësive dhe e veçantive të programit dhe të lëndëve. Në formimin profesional të studentëve të programit Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare" jo të gjitha lëndët kanë të njëjtin rol.

- Te format e kontrollit të dijeve, në diplomën Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", nuk përdoren testime gjatë vitit apo provime të pjesshme. Kjo nuk garanton cilësi të kontrollit të dijeve dhe angazhim dhe impenjim të studentëve për të siguruar procesin e të mësuarit të vazhduar.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Pranimet në programin e studimeve Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", prane KUB, në vitin akademik 2017-2018 janë me kuote të paracaktuar. Kolegji ka paracaktuar për këtë program 60 kuota. U njihet e drejta për të aplikuar në këtë program studimi shtetasve shqiptarë të pajisur me dokument zyrtar të perfundimit të studimeve Bachelor në Drejtësi, në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalente sipas kriterëve të vendosura nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë). Të drejtën për të aplikuar për pranimin në ciklin e dytë të studimeve e kanë edhe studentët e huaj, bazuar në marrëveshjet ndërkombetare dypaleshe ose shumëpaleshe.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Mesatarja e studentëve në hyrje varion nga 7 në 7.6 ndërsa në dalje nga 7.89 në 9. Në dy vite akademike 2014-2015 dhe 2015-2016, në Kolegj janë pranuar një numër i konsiderueshëm studentësh me transferime në vitin e dytë të studimeve, gjë që përbën një problem të plotësimit të lëndëve dhe të integritetit tërësor të studentëve apo të plotësimit të programeve me provime suplementare. Të dhëna të detajuara jepen në tabelën 19 të Aneksëve.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Në vitin akademik 2016-2017 KUB-i ka regjistruar në këtë program 28 studentë për herë të parë dhe ka diplomuar 18 prej tyre. Pjesa tjetër vijon të përmbushë detyrimet e programit. Nota mesatare e studentëve të pranuar ka qenë 7, relativisht e kënaqshme. Në vitin akademik 2017-2018 ka pranuar 18 studentë me notë mesatare 7.

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Në vitin e fundit akademik janë diplomuar 18 studentë, me notë mesatare 8.5.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Kolegji lejon dhe pranon transferimet e studenteve brenda programeve të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion, filial apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, private ose publike, vendase (nuk ka raste të transferimit të studimeve nga institucione të huaja), për të vijuar studimet pranë Institucionit, duke ju nënshtruar një procedurë që vlerëson dhe lejon pranimin e tyre nepermjet krediteve të akumuluar nga studimet e mëparshme sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren e Transferimeve. Në disa vite, numri i studentëve të transferuar nga jashtë në KUB është relativisht i madh, ky fenomen kërkon një vëmendje më të madhe për të integruar në vijimin normal të programeve të studimeve, për kandidatë që kanë formim relativisht të ndryshëm të studimeve në nivelin Bachelor.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Fakulteti i Drejtësisë ka informacione të detajuara ndër vite për punësimin e të diplomuarve. Sipas statistikave të raportit të vetëvlerësimit, numri i të punësuarëve në vende pune që përputhen me diplomën e fituar është mjaft i ulët. Të diplomuarit e vitit akademik 2012-2013 janë punësuar vetëm 66 % në përputhje me diplomën, në vitin akademik 2013-2014 vetëm 40 %, në vitin akademik 2014-2015 vetëm 31,8 %, e kështu me rradhë. Ndërkohë që në raportin e vetëvlerësimit, numri total i të diplomuarëve ndër vite është më i lartë se sa numri i të diplomuarëve të listuar në tabelën e punësimit (kollona e fundit e tabelës në faqen 57 të raportit të vetëvlerësimit). Në referim të numrit total të të diplomuarëve, të përmendur në tabelën 17 të raportit, të punësuarit në përputhje me diplomën sipas viteve janë akoma më të ulëta dhe konkretisht: në vitin akademik 2012-2013 janë 61,6 %, në vitin akademik 2013-2014 janë 8,7 %, në vitin akademik 2014-2015 vetëm 17 %, në vitin akademik 2015-2016 vetëm 21,2 %, e kështu edhe në vitet vijuese.

Rekomandojmë që KUB-i të studiojë tregun e punës dhe të ndjekë në vijueshmëri ecurinë e diplomave të Programit Master i Shkencave në "E drejta civile dhe tregëtare".

Numri total të diplomuarve

Për gjithë periudhën e gjashtë viteve akademike, 2012-2017, KUB-i ka diplomuar 94 studentë në këtë program studimi.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Nga 94 studentë të diplomuar rezultojnë të punësuar vetëm 43 studentë, ose më pak se 47 % e tyre.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Numri total i studentëve të punësuar jo në përputhje me diplomën është 22 veta.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

- Statistikat e punësimit 2017-2018
- Paketa udhëzuese për zhvillimin e praktikave mësimore
- Marrëveshje bashkëpunimi

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve Master i shkencave, zotërojnë së paku diplomën universitare Bachelor, dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Kriteri 2 Pranimit në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "për arsimin e lartë në RSH", i ndryshuar dhe akteve ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni,</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomën edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimit "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve Master i shkencave dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, niveli i kërkuar i gjuhës angleze është C1, sipas kuadrit evropian të gjuhëve.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Kriteret e pranimit të studentëve janë ndërtuar sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas rregullores së programit të studimit. Fakulteti i Drejtësisë, në fillim të çdo viti ka një javë të ambientimit të studentëve me fakultetin.</p> <p>Kolegji ka respektuar kriterin e përgjithshëm të gjuhës angleze të mbrojtur para diplomimit. Deri në vitin akademik 2017-2018 Fakulteti ka shqyrtuar disa here politikat e pranimit, por nuk ka pasur dhe nuk ka realizuar ndryshime të rëndësishme në kriteret e përgjithshme të pranimit.</p> <p>Ndryshimi i kriterit të përgjithshëm të pranimit, është në kompetencë të departamentit, por në këto 6 vite akademike nuk ka ndonjë rishikim të politikave të pranimit apo ndonjë kriter specifik.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimit që ofron dhe lidhur me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim mbas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë brenda dhe jashtë vëndit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p>	<p>Kolegji informon studentët lidhur me procesin e aplikimit, si dhe në fillim të çdo viti të studimeve për organizimin dhe kohezgjatjen e programit të studimit. Forma të tjera informimi janë fletë palosjet, broshurat dhe faqja e internetit e Kolegjit.</p> <p>Në fund të çdo semestri studentët plotësojnë pyetësorë në të cilët vlerësojnë pedagogët dhe mësimdhënien në një seri pyetjesh të mirëmbledhura (janë gjithsej 13 pyetje).</p> <p>Kolegji ka Zyrën e Këshillimit të Karrierës, e cila është e lidhur si me tregun e punës ashtu edhe me studentët. Ajo i këshillon studentët për nevojën e përshtatjes së dijeve dhe aftësive të tyre me kërkesat e tregut të punës.</p>

Studentët janë të mirëinformuar lidhur me akreditimin institucional të KUB-it.

Në KUB organizohen herë pas here takime të stafeve dhe të studentëve me përfaqësues dhe drejtues të institucioneve private dhe publike të cilët prezantojnë edhe kërkesat e tyre lidhur me kriteret e punësimit dhe me vëndet e punës që ofrojnë.

Ne Kolegj, ka një numër të kufizuar studentësh dhe një raport relativisht më të mirë të mbulimit të studentëve me pedagoge, cka bën që stafi akademik dhe strukturat drejtuese të jenë gjithnjë me afër me jetën dhe problematikat e studentëve.

Standardi IV.3 - Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit të ciklit të dytë dhe programet e integruara të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në programet e studimeve që kanë përfunduar;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;

Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.

Institucioni disponon të dhëna të pjesshme statistikore për numrin e të diplomuarve. Keto të dhëna disponohen nga sekretaria mësimore dhe menaxhohen nga kryesekretari. Lidhjet e Departamentit me ish të diplomuarit (ALUMNI) janë rastësore.

Kryesekretarja mësimore i dorezon statistikat përkatëse, periodikisht, në zyrën e statistikave ne MASR.

Institucioni ka të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri ne diplomim. Te dhenat janë të regjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Indeksit, në Regjistrin e Rezultateve Akademike, në Regjistrin e Diplomave. Të dhënat janë edhe në variantin elektronik. Të dhënat statistikore i raportohen MASR dhe Rektoratit.

Standardi IV.4 Institucioni disponon një bazë të dhënash lidhur me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programit të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të studimeve të programeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vëndet e punësimit të tyre;

Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve, etj. .

KUB-i, nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe Zyrës për Zhvillimin e Karrierës mban një bazë të dhënash për punësimin e studentëve, por këto të dhëna nuk janë të azhornuar gjithnjë.

KUB-i nuk ka të dhëna të mirëazhornuara që ndjekin në vijimësi karrierën e studentëve mbas përfundimit të studimeve dhe fatin e tyre të mëtejshëm.

Standardi IV.5 Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhduar dhe të detajuar në lidhje me programet e studimeve.

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit.</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen rregullisht për çdo element të programit, për detyrimet dhe për afatet dhe statusin e akreditimit.</p> <p>Për çdo syllabus, pedagogët komunikojnë për çdo student vlerësimin e tyre me notë të ecurisë së studimeve, të vlerësimit dhe të çdo detyrimi të shlyer.</p> <p>Në rastet kur studentët kontestojnë vlerësimin, ata kanë akses të kontaktojnë përgjegjësin e departamentit apo drejtues të tjerë.</p>
<p>Standardi IV.6 Institucioni angazhon personelin e tij për kujdesjen ndaj studentëve</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillim të karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale në rastet kur parashikohet një gjë e tillë.</p>	<p>KUB-i, nëpërmjet Zyrës për Zhvillimin e Karrierës u mundëson studentëve pjesmarrje në leksione të hapura, trajnime të veçanta, intershipe, dhe praktika të ndryshme profesionale.</p> <p>KUB-i ka krijuar një klimë miqësore me studentët, kjo edhe në saj të raporteve të mira të numrit të studentëve për një pedagog.</p>
<p><u>Konkluzione:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Pranimet e studentëve në Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregëtare", bëhet në përputhje me ligjin, statutin dhe rregulloren e KUB-it, • Studentët kanë informacionet e duhura lidhur me ecurinë e tyre në programin e studimeve por edhe lidhur me rrjetin ALUMNI, • Studentëve u garantohet privatësia dhe koefidencialiteti i komunikimeve të rezultateve dhe vlerësimeve, • Studentët kanë akses edhe në veprimtari të tjera të karakterit sportiv, social, dhe veprimtari të tjera në nivel lokal, apo kombëtar. <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Piesa përshkrimore

Veprimtaria kërkimore dhe shkencore e Fakultetit të Drejtësisë që mbulon programin e studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregëtare", është në funksion të politikës teresore të Kolegjit dhe në përshtatje edhe me zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit. Përqendrohet kryesisht:

- rritjen e performancës shkencore të stafit akademik,
- rritjen e nivelit shkencor dhe akademik të stafit në auditor,
- zgjerimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit të KUB me institucione të tjera kërkimore shkencore dhe me shkolla të tjera të larta, të fushës së ekonomisë dhe të biznesit,

- zgjerimit të pjesmarrjes së stafit në konferenca shkencore si dhe nëpërmjet organizimit të konferencave shkencore prej vetë KUB-it,
- bashkëpunimit me lektorë të tjerë të shquar brënda vëndit, nga fusha e ekonomisë dhe biznesit.

Perfshirja e pedagogëve në projekte të kërkimit shkencor ka qene individuale dhe e kufizuar në kuader të projekteve të tyre të Doktoratës ose kërkimin e tyre shkencor. Nuk ka pasur projekte të ndërmarra direkt nga KUB, në rang Departamenti, Fakulteti apo Kolegji, me përjashtim të një pjesmarrje si partner në një projekt kombëtar në kuadrin e rritjes së pjesmarrjes së femrave në biznes, që synonte promovimin dhe mbështetjen e iniciativave sipërmarrëse të femrave.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 22 e Anekseve)

KUB ka zhvilluar katër konferenca shkencore kombëtare për zhvillimet bashkëkohore, për impaktin ekonomik dhe ligjor të ndryshimeve globale, për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të ekonomisë shqiptare, për reformat në fushën e ekonomisë dhe të drejtësisë dhe sfidat e vëndit tonë, për pushtetin gjyqësor dhe integrimin ekonomik, për mbrojtjen e mjedisit dhe sfidat e menaxhimit mjedisor, për përgjegjësitë sociale të korporatës, për dinamikën e të drejtës dhe të ekonomisë që nga periudha e mesjetës deri në legjislacionin bashkëkohor, për lidhshirësinë europian, për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian, etj.

Kërkimi shkencor më tepër ka qënë fokusuar në pune individuale të pedagogëve se sa në veprimtari të organizuara në trajtën e projekteve institucionale. Fakulteti dhe Departamenti nuk janë të përfshirë në ndonjë projekt të veçantë kërkimor dhe shkencor.

Puna shkencore e pedagogëve deri më tani ka qënë individuale, e orientuar kryesisht në botime artikujsh, punime shkencore të botuara dhe të prezantuara në konferenca nderkombetare, botime tekstesh mësimore, studime për marrjen e titujve akademike, etj.

Mbështetja financiare e institucionit ka qënë e kufizuar, e përqëndruar në mbështetje me lejë të pagueshme, vënien në dispozicion të mjediseve dhe e fokusuar vëtem në literaturë. Ka munguar mbështetja financiare për projekte kërkimore apo pjesmarrje në veprimtari kërkimore jashtë vëndit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
Standardi III. 3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve .	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinat përkatëse.	Një pjesë e personelit akademik është e përfshirë në publikim të artikujve shkencorë në revista apo në buletine shkencore.
Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	KUB-i publikon revistën e tij periodike "Scientific Journal of Professional Studies" me ISSN, që përmban shkrime me karakter shkencor dhe problematik të pedagogëve dhe kërkuesve pranë KUB-it.

Standardi III. 4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj me një personel akademik të kualifikuar .	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron njëcertifikatë për njohje të avancuar të saj.</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë prej së paku një semestër.</p>	KUB-i nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj
Standardi III. 10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij .	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe speciale për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik dhe të personelit kërkimor shkencor.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brënda dhe jashtë vëndit.</p>	<p>Institucioni nuk ka organizuar programe të posaçme për kualifikimin e mëtejshëm profesional dhe pedagogjik të personelit akademik. Kualifikimi i mëtejshëm akademik dhe profesional i tyre ka qënë dhe është pjesë e angazhimit të tyre individual.</p> <p>KUB-i nuk ka mundësuar kualifikime të mëtejshme brenda dhe jashtë vëndit të stafit akademik, por nuk ka penguar asnjë pedagog që ka pasur mundësi të ndjekë kualifikime të tjera dhe pjesëmarrje në aktivitete akdemike dhe shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>
Standardi III. 11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash lidhur me veprimtarinë kërkimore dhe shkencore të personelit akademik të tij .	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angzhuar në këtë program studimi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj, apo kumtesa ne konferenca) brënda dhe jashtë vëndit, të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore dhe shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>KUB-i disponon të dhëna lidhur me studimet shkencore, librat, tekstet, artikujt dhe pjesmarrjet e çdo pedagogu, që është i angazhuar në programin e studimeve Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregëtare"</p> <p>Ka bazën e të dhënave me kualifikimet e personelit dhe me pjesmarrjet e stafit në vëprimtaritë shkencore brënda dhe jashtë vëndit,</p>
Konkluzione:	
<ul style="list-style-type: none"> • KUB-i ka krijuar kushtet për veprimtari kërkimore dhe shkencore të stafit akademik të angazhuar nëprogramin e studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare", • KUB ka realizuar vetë disa konferenca shkencore dhe veprimtari të tjera të kësaj natyre në fushat e të drejtës. • KUB-i publikon revistën e vet periodike me ISSN ku shkruajnë dhe botojnë artikuj e tyre 	

pedagogët dhe stafi akademik.

- Tërheq dhe fton në auditoret e tij personalitet nga bota akademik e vendit.
- Nuk është i përfshirë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në ndonjë projekt të karakterit institucional ku të jetë përfshirë Departamenti, apo Fakulteti.
- Ka të dhëna për botimet dhe veprimtarinë shkencore dhe botuesetë secilit pedagog që është i angazhuar në programin e studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare".
- Veprimtaria shkencore ka më tepër pamjen e punës dhe angazhimit kërkimor dhe akademik individual se sa të një veprimtarie institucionale.
- Nuk ka projekte kërkimore të përbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë apo të fushës së kërkimit shkencor.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen kryesisht.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Fakulteti i Drejtësisë, nëpërmjet Rektoratit të Kolegji Universitar të Biznesit ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me disa universitete brënda dhe jashtë vëndit. Marrëveshjet parashikojnë:

- Shkëmbimin e pedagogëve, kërkimeve shkencore, personelit administrativ dhe teknik;
- Shkëmbimin e studentëve të padiplomuar, të diplomuar, studentëve të doktoraturës dhe post-doktoraturës;
- Projekte të përbashkëta kërkimore;
- Konferenca të përbashkëta dhe programe kulturore;
- Shkëmbime të materialeve akademike, botimeve dhe dokumentacioneve të tjera.
- Praktika mësimore, mësimin e gjuhëve të huaja, internshipe, trajnime, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Fakulteti vlerëson mobilitetin e personelit akademik si një mundësi strategjike në përmirësimin e pozitës konkurruese dhe cilësisë, integrimin dhe përshtatjen me programet ndërkombëtare, transferimin e informacioneve dhe metodave që prodhojnë vlerë të shtuar në procesin e edukimit. Gjatë kësaj periudhe pedagogët janë angazhuar në veprimtari si pjesëmarrje në ëorkshop-e, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, tryeza të rrumbullakëta, leksione të hapura, trajnime dhe specializime, kurse etj.

Të dhënat e detajuara mbi bashkëpunimin e KUB me institucione kombëtare e ndërkombëtare jepen në tabelën 23 të Anekseve.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

Në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore të studentëve, Fakulteti ka arritur bashkëpunime me institucione apo biznese të ndryshme si: Universiteti i Krajovës, Rumani, Qendrës për studime Europiane Iasi, Rumani, Akademia Internazionale Constantiniana Itali, Universiteti i Shkencave të Aplikuara Hungari, Universiteti i Ekonomisë Kombëtare dhe Botërore, Bullgari, Arsimit të Larta në Shqipëri si: Universiteti LUARASI, UBT, Universiteti i Durrësit, Universiteti Polis, qendra administrative dhe biznese si: Njësia Bashkiake numër 1, Tiranë, Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë Tiranë, Gjykata Administrative, Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit, Kolegji Dukagjini Kosovë, si dhe shumë institucione, qendra biznesi, dhe ndërmarrje private apo publike, etj.

Të dhënat e detajuara jepen në tabelën 24 të Anekseve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
Standardi V.3 - Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vëndas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve Master Profesional, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregëtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve Master i shkencave, ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytëinstitucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit,</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucioneshe dhe kompanish, publike dhe private me të cilat mundëson bashkëpunimin për kryerjen e praktikave mësimore dhe shkëmbimin e informacionit.</p> <p>Institucioni e ka praktikë pune që edhe praktikantët mësimore dhe stazhet e studentëve i mundëson dhe i ofron nëpërmjet këtyre marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve institucionale.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>KUB-i ka krijuar klimën e nevojshme për bashkëpunimin midis personelit të angazhuar në programin e studimit Master i shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare".</p> <p>Njësia bazë, Departamenti i të drejtës civile, organizon herë pas here analiza periodike lidhur me ecurinë dhe progresin e programit të studimit duke nxitur në këtë mënyrë bashkëpunimin e frytshëm midis personelit.</p>

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vëndas dhe të huaj

Kriteri 1 Institucioni, për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vëndit dhe aktorët e biznesit vëndas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkëpunim me punëdhënësit;

Kriteri 2 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programit të studimeve.

KUB-i ka vendosur një sërë marrëdhëniesh bashkëpunimi me homologët e tij jashtë vëndit dhe me aktorët e biznesit.

Institucioni ka gjithashtu edhe marrëdhënie bashkëpunimi me operatorë dhe aktorë të biznesit vëndas që janë njëherësh punëdhënës potencialë për të sapodiplomuarit pranë Fakultetit të Drejtësisë nëprogramin e studimeve Master i Shkencave në "E drejtë civile dhe tregtare".

Institucioni i ka riparë dhe ka rinegociuar marrëdhëniet e ndryshme të bashkëpunimit midis tij dhe operatorëve apo aktorëve të tjerë.

Konkluzione:

- Institucioni bashkëpunon me disa institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda vëndit, prej nga vijnë pedagogët dhe stafi me kohë të pjesshme i ftuar për mësimdhënie. Niveli akademik i stafit të ftuar, në vitet e fundit ka ardhur në rritje.
- Marrëveshjet e bashkëpunimit të KUB-it me institucione të tjera homologe, brenda dhe jashtë vëndit të orientuara kryesisht në praktikën mësimore dhe organizimin e aktiviteteve të konferencave shkencore.
- Nuk ka projekt të karakterit kombëtar apo rajonal ku të jetë përfshirë Departamenti apo Fakulteti.
- Me gjithë se ka shumë marrëdhënie dhe marrëveshje bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë dhe vëndorë, ka pak ose aspak pedagogë të huaj që bëjnë vizita akademike dhe leksione të hapura.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimi nga akreditimi i parë	Statusi aktual
1. Institucioni të bëjë përpjekje për të gjeneruar sa më shpejtë një bilanc financiar pozitiv.	Plotësuar
2. Të merren masa për të rritur numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi, një pjesë thelbësore për mbarëvajtjen e institucionit.	Plotësuar
3. Të bëhet përpjekje që studentët të kenë sa më shumë akses në bibliotekat on-line.	Plotësuar
4. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.	Plotësuar

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Programi i studimit është specifik dhe institucioni ka një avantazh krahasuar me IAL e tjera.
2. Institucioni është i profilizuar në fushën e programeve të studimit me fokus biznesin.
3. Progresi dukshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
4. Strukturë organizative efektive.
5. Disponibiliteti i një infrastrukture moderne dhe e bollshme krahasuar për numrin efektiv të studentëve.
6. Hartimi dhe përdorimi i një dokumentacioni ligjor dhe pedagogjik në nivel institucional dhe programor dëshmon për një veprimtari të institucionalizuar dhe të standardizuar.
7. Bashkëpunime të mira me partnerë të tjerë të fushës së biznesit dhe të asaj akademike.
8. Staf akademik i kualifikuar dhe me eksperiencë të gjerë në fushat respektive.

b. Pika të dobëta:

1. Numri relativisht i ulët i studentëve të regjistruar në program.
2. Angazhimi i limituar i pedagogëve në projekte kërkimore kombëtare apo ndërkombëtare.
3. Vështirësi në diversifikimin e burimeve të financimit si institucion i vetëfinancuar në tregun shqiptar.
4. Mungesa e ofrimit të lëndëve të programit në gjuhë të huaj, do të shërbente ndërkombëtarizimit të programit të studimit.

c. Mundësitë:

1. Interesimi në rritje i kompanive private dhe organizatave publike për të rekrutuar studentë cilësorë.

2. Marrëveshjet e shumta me bizneset dhe bankat për realizimin e praktikave mësimore dhe rritjen e mundësive të punësimit për studentët.

d. Pengesat:

1. Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor krijojnë problem në përshtatjen e institucioneve arsimore.
2. Mungesa e informacionit në tregun e punës lidhur me cilësinë dhe vlefshmërinë e diplomave të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë.
3. Tranzicioni i tejzgjatur i ekonomisë shqiptare çon në krijimin e një mjedisi jo shumë të qëndrueshëm dhe transparent.
4. Mungesa e një ligji të posaçëm që rregullon dhe detyron praktikën e studentëve në mjediset e biznesit shqiptar.

III. SUMMARY ANALYSIS OF THE EER BY SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES & THREATS)

a. Strengths:

1. The study program is specific and the institution has an advantage compared to other HEIs.
